

## GIOVAN BATTISTA PELLEGRINI

(23 shkurt 1921 – 3 shkurt 2007)



Giovan Battista PELLEGRINI (<http://www.cisam.org>)

Para disa ditësh ndërroi jetë në Padova, në moshën 86-vjeçare, glotologu i shquar italian Giovan Battista PELLEGRINI, që për vite të tëra dhe me sukses një pjesë të energjive krijuese ia kushtoi filologjisë ballkanike, në kuadrin e së cilës një vend të rëndësishëm zë dhe albanologjia.

Ndoqi dhe konsolidoi më tej traditën e studimeve filologjike ballkanike, të filluar prej mësuesit, dhe më vonë kolegut e bashkëpunëtorit të tij, Carlo TAGLIAVINIT<sup>1</sup>.

Lindi në vitin 1921 në Cencenighe (Belluno). Studimet e larta filologjike i kreu në Universitetin e Padovës, ku u diploma në vitin 1945. Po atje, një vit më vonë, mbroi doktoraturën në glotologji. Gjatë periudhës 1946-1963 kreu veprimtari didaktike në universitetet e Pizës, Palermos dhe Triestes, ndërsa duke u nisur nga viti 1964 mori përsipër drejtimin e katedrës së glotologjisë pranë Universitetit të Padovës.

Në vijim të pensionimit të pararendësit të tij, Carlo TAGLIAVINIT, që për disa vite solli si pasojë dhe ndërprerjen e funksionimit të Seminarit të Filologjisë Ballkanike dhe Shqipe (themeluar prej

---

<sup>1</sup> Ja si i përshkruan vetë PELLEGRINI, në një artikull të gjerë përkujtimor - botuar në vitin 1982 me titullin *Carlo Tagliavini e gli studi bellunesi* - marrëdhëniet e tij shkencore me TAGLIAVININ: “Ricordare (...) una figura di grande studioso (...), quale fu il nostro Maestro Prof. Carlo Tagliavini, mi è sembrato un dovere di discepolo e di continuatore, per lo meno per alcuni filoni della sua amplissima produzione scientifica, e non tanto per le sue ricerche balcanico-danubiane in cui egli eccelse fin dall'adolescenza e divenne poi uno dei massimi specialisti europei, quanto come prosecutore nella sua intensa attività nel campo della dialettologia alpina, prealpina, veneta, friulana ecc., ove mi auguro di aver continuato la sua opera e i suoi indirizzi.”, botuar në: Dolomiti V/6, f. 7.

TAGLIAVINI qysh në vitin 1935), PELLEGRINI shpuri përpara këtë traditë<sup>2</sup> deri në fund të vitit akademik 1990-1991.

Për cilësinë dhe rendimentin e tij të lartë shkencor (mbi 800 tituj), që pasqyrohet dhe në pjesëmarrjen në një mori aktivitetesh shkencore e projektesh kërkimore, PELLEGRINI u nderua me një sërë çmimesh dhe titujsh, ndër të cilët mjafton të përmendet dhënia e diplomës *Honoris Causae* prej Universitetit të Budapestit (1989) apo akordimi i çmimit kombëtar të Presidentit të Republikës italiane për shkencat morale, historike dhe filologjike (1990).

Interesat shkencore të PELLEGRINI shtrihen në sektorë të ndryshëm të gjuhësisë historike, duke filluar nga toponomastika e onomastika deri tek gjuhësia kontaktuale e dialektologjia, nga disiplina e romanistikës deri tek ajo e indogjermanistikës, ballkanistikës, etj. Ndër tematikat më të rëndësishme, të cilave iu përkushtua gjatë veprimtarinë e tij shkencore, duhen përmendur toponomastika dhe onomastika italiane, gjuhët e lashta të gadishullit apenin - në veçanti ato të pjesës verilindore të tij -, dialektologjia e venetishtes dhe venecianishtes, çështja ladine, marrëdhëniet gjuhësore ndër Adriatike, elementet gjuhësore të huazuara prej arabishtes (kryesisht) në dialektet bazë italo-romanike jugorë, filologjia ballkanike, etj.

Duke ndjekur parimet e filologjisë ballkanike të krahasuar, të themeluar prej Carlo TAGLIAVINI, dhe jo rrallë, duke ritrajtuar nga këndvështrime të tjera të njëjtat<sup>3</sup> çështje gjuhësore, PELLEGRINI i dhuroi komunitetit shkencor një sërë punimesh krahasuese, si p.sh. artikullin e titulluar *Concordanze balcaniche nell'uso dell'articolo determinativo*<sup>4</sup>, përkthyer dhe në shqip<sup>5</sup>, apo vëllimin *Ricerche linguistiche balcanico-danubiane*<sup>6</sup>, në të cilin janë përpunuar dhe përmbledhur 15 studime të tij të botuara në vitet 1957-1990. Me plot vlera janë dhe studimet onomastike në lidhje me përkimet gjuhësore italo-ballkanike, ndër të cilat mjafton të përmenden: *Convergenze italo-balcaniche negli elementi di origine orientale*<sup>7</sup>, përkthyer dhe në serbokroatisht<sup>8</sup>, *Convergenze linguistiche italo-romene*<sup>9</sup>, dhe

---

<sup>2</sup> Në një letër private të datës 5 shkurt 2001, të drejtuar autorit të këtyre rreshtave, Profesor PELLEGRINI thekson: “(...) *qui a Padova non ho voluto che si interrompesse la tradizione di balcanistica* (...)”

<sup>3</sup> Le të përmendet këtu çështja e prapavendosjes së njëjës së shquar në gjuhët ballkanike, si një prej tipareve të përbashkëta të tyre, që është trajtuar dhe prej Carlo TAGLIAVINI në një sërë punimesh. Ndër to mjafton të citohet TAGLIAVINI, Carlo (1923): *Sulla questione della posposizione dell'articolo*, në: Dacoromania III, f. 515-522.

<sup>4</sup> Botuar në vitin 1995 në: LUPU, Coman/ RENZI, Lorenzo (a cura di): Studi rumeni e romanzi. Omaggio a Florica DIMITRESCU e Alexandru NICULESCU, vol. I: Linguistica, etnografia, storia rumena, Padova: Unipress, f. 201-218.

<sup>5</sup> PELLEGRINI, Giovan Battista (1997): *Konkordancat ballkanike në përdorimin e njëjës shqese*, në: ALTIMARI, Francesco/ BELLUSCIO, Giovanni (a cura di): Atti del 2° Seminario Internazionale di Studi Albanesi (Arcavacata Rende, 8-10 giugno 1994), Roma: Herder [Quaderni del Dipartimento di Linguistica dell'Università di Calabria, 14], f. 305-317

<sup>6</sup> PELLEGRINI, Giovan Battista (1997): *Ricerche linguistiche balcanico-danubiane*, Roma: La Fenice

<sup>7</sup> Botuar në vitin 1968 në: Annali della Facoltà di Magistero dell'Università di Palermo, f. 203-235.

<sup>8</sup> PELLEGRINI, Giovan Battista (1969): *Italijansko-balkanske podudarnosti u elementima orijentalnog porekla*, në: Prilozi za knjževnost, jezik, istoriju i folklor XXX, f. 56-76

<sup>9</sup> Botuar në vitin 1986 në: Studi albanologici, balcanici e orientali in onore di Giuseppe VALENTINI, S.J., Firenze: Leo S. Olschki [Studi Albanesi, VI], f. 147-167. PELLEGRINI koordinoi përgatitjen e kësaj përmbledhjeje dhe shkroi dhe parathënie.

*Una concordanza veneto-balcanica nella terminologia della «pipa»*<sup>10</sup>. Në brendësi të këtyre studimeve PELLEGRINI merr parasysh shpesh dhe gjuhën shqipe.

Por filologu i shquar iu përkushtua dhe hulumtimeve filologjike mbi gjuhë të veçanta ballkanike. Përveç studimeve në lëmin e rumanishtes, ungarishtes dhe sllavishtes ballkanike ai i kushtoi vëmendje dhe gjuhës shqipe, duke na dhuruar një sërë punimesh me vlera.

Duke lënë mënjanë shkrimin e shkurtër divulgativ *In Albania*<sup>11</sup>, ndër punimet me karakter të përgjithshëm mbi gjuhën shqipe duhet përmendur artikulli i titulluar *Alcune caratteristiche fondamentali della lingua albanese*<sup>12</sup>, në të cilin paraqiten shkurtimisht disa prej veçorive kryesore të gjuhës shqipe, të trajtuara më hollësisht disa vite më vonë në *opus magnum*-in e tij albanologjik, *Avviamento alla linguistica albanese*, që do të trajtohet më poshtë.

Në kuadrin e studimit të elementeve latine në gjuhën shqipe, kontributi i Giovan Battista PELLEGRINIT zë një vend të rëndësishëm përkrah punëve të Norbert JOKLIT, Eqrem ÇABEJT, Carlo TAGLIAVINIT e të tjerëve. Përveç artikullit më të njohur *Alcune osservazioni sull'elemento latino dell'albanese*<sup>13</sup>, përkthyer dhe në shqip<sup>14</sup>, duhen përmendur dhe dy punë të tjera të tij të titulluara *I rapporti linguistici interadriatici e l'elemento latino dell'albanese*<sup>15</sup> dhe *It. ant. forneccio, alban. furrëqí «fornicatio»*<sup>16</sup>.

Në këndvështrimin dialektologjik nuk mbetën jashtë vëmendjes shkencore të PELLEGRINIT as të folmet shqipe jashtë arealit gjuhësor të vazhdueshëm ballkanik të shqipes. Kështu, ndër studimet gjuhësore mbi arbërishten bëjnë pjesë dhe tre punë të PELLEGRINIT, të titulluara *Appunti sull'albanese d'Italia*<sup>17</sup>, *Il lessico dell'Arbëresh ed i turchismi*<sup>18</sup>, dhe *Una breve inchiesta arbëreshe di J. Baudouin de Courtenay*<sup>19</sup>, ndërsa në artikullin *Note linguistiche arvanitiche*<sup>20</sup> trajtohen disa çështje gjuhësore të arvanitishtes.

---

<sup>10</sup> Botuar në vitin 1990 në: Abruzzo. Rivista dell'Istituto di Studi Abruzzesi XXIII-XXVIII (Scritti offerti a Ettore PARATORE ottuagenario), f. 387-398.

<sup>11</sup> Botuar në vitin 1996 në: Quaderni del Lombardo-Veneto 42, f. 4-7.

<sup>12</sup> Botuar në vitin 1992 në: LANDI, Addolorata/ DEL PUENTE, Patrizia (a cura di): Le comunità albanesi d'Italia. Atti del II Convegno internazionale di studi sulla lingua albanese (Fisciano, 4-6 novembre 1990), Napoli: Arte tipografica, f. 89-118.

<sup>13</sup> Botuar në vitin 1983 në: Studia Albanica XX/1, f. 63-83.

<sup>14</sup> PELLEGRINI, Giovan Battista (1982): *Disa vëzhgime mbi elementin latin të shqipes*, në: Studime Filologjike (XXXVI)-XIX/ 3, f. 85-102

<sup>15</sup> Botuar në vitin 1980 në: Abruzzo. Rivista dell'Istituto di Studi Abruzzesi XIX, f. 31-71.

<sup>16</sup> Botuar në vitin 1980 në: Revue Roumaine de Linguistique XXV, f. 379-384, si dhe në vëllimin e sipërpërmendur *Ricerche linguistiche balcanico-danubiane*, f. 153-161.

<sup>17</sup> Botuar në vitin 1994 në: ALTIMARI, Francesco/ SAVOIA, Leonardo M. (a cura di): I dialetti italo-albanesi. Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe, Roma: Bulzoni, [Biblioteca di Cultura, 488], f. 107-120.

<sup>18</sup> Botuar në vitin 1989 në: AA.VV.: Le minoranze etniche e linguistiche. Atti del 2° Congresso internazionale (Piana degli Albanesi, 7- 11 settembre 1988), Palermo: Renna, f. 327-362.

<sup>19</sup> Botuar në vitin 1980 në: Romanistik in Geschichte und Gegenwart I/2, f. 149-158.

<sup>20</sup> Botuar në vitin 1997 në: Ponto-baltica 7, f. 163-170.

Krahas artikullit të titulluar *Gli studi di albanologia in Italia*<sup>21</sup>, në kuadrin e hulumtimeve në fushën e historisë së albanologjisë duhet të përmendet dhe analiza që në një sërë botimesh PELLEGRINI i bëri kontributit albanologjik të pararendësit të tij, Carlo TAGLIAVINIT, ndër të cilët mjafton të vihet në dukje punimi *Carlo Tagliavini e gli studi albanologici*<sup>22</sup>, që PELLEGRINI, më 5 dhjetor 1996, paraqiti si kumtesë në Shkodër, gjatë vizitës së tij të tretë dhe të fundit në Shqipëri, në kuadrin e konferencës shkencore *Kontributi i albanologëve italianë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, kushtuar Carlo TAGLIAVINIT dhe të organizuar prej Departamentit të Gjuhësisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, në bashkëpunim me Ambasadën Italiane në Republikën e Shqipërisë.

Objektet e recensioneve të tij me interes albanologjik të drejtpërdrejtë janë dy botime të Martin CAMAJT<sup>23</sup>, si dhe vepra madhore e Giuseppe VALENTINIT *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV e XV, J. Valentini S. J. Labore reperta et transcripta*<sup>24</sup>.

Vepra më e rëndësishme albanologjike e Giovan Battista PELLEGRINIT, në të cilën pasqyrohet dhe një pjesë e mirë e rezultateve të paraqitura në punimet e tij të sipërpërmendura, është padyshim monografia e titulluar *Introduzione allo studio della lingua albanese*<sup>25</sup>, përgatitur fillimisht në formë dispensash për studentët e Seminarit të Filologjisë Ballkanike, pranë Institutit të Glotologjisë të Universitetit të Padovës. Në këtë manual përshkruhen fillimisht gjuhët ballkanike para periudhës romake. Më pas në qendër të vëmendjes vihet fonetika historike e shqipes, si dhe problemi i shtresëzimit të leksikut të saj, duke u ndalur më tepër tek çështja e elementeve latine. Pjesa e fundit e veprës përmban një paraqitje të dëshmimeve gjuhësore e të teksteve më të hershme shqipe, si dhe një antologji. Rreth pesëmbëdhjetë vjet më vonë PELLEGRINI filloi ta përpunojë, plotësojë dhe aktualizojë monografinë e sipërpërmendur duke e titulluar *Avviamento alla linguistica albanese*<sup>26</sup>. Ribotimi i saj, falë dhe interesimit të Antonino GUZZETTËS, bëhet i mundur në vitin 1995. Pas tre vitesh, nën kujdesin e Francesco ALTIMARIT doli në dritë ribotimi i fundit i kësaj vepre<sup>27</sup>.

---

<sup>21</sup> Botuar në vitin 1996 në: GUZZETTA, Antonino ( a cura di): Nuovi orientamenti della linguistica e della letteratura albanesi. Atti del XVIII Congresso Internazionale di Studi Albanesi (Palermo, 24-28 novembre 1992), Palermo: C. Alaimo, f. 23-39.

<sup>22</sup> Botuar në vitin 1997 në: OSMANI, Tomor/ PEPA, Simon (përg.): Studiuesit italianë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Shkodër: Shtypshkronja “Volaj” [Studime shqiptare - Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, 7], f. 21-26.

<sup>23</sup> PELLEGRINI, Giovan Battista (1972): CAMAJ, Martin (1971): La parlata albanese di Greci in provincia di Avellino, Firenze: Leo S. Olschki, në: Parole e metodi 3, f. 113-117, dhe PELLEGRINI, Giovan Battista (1985): CAMAJ, Martin (1984): Albanian Grammar: with Exercises, Chrestomathy and Glossaries, Wiesbaden: Harrassowitz, në: Archivio Glottologico Italiano 70, f. 141-147.

<sup>24</sup> Botuar në vitin 1972 në: Ateneo Veneto XCV, f. 116-119.

<sup>25</sup> PELLEGRINI, Giovan Battista (1997): *Introduzione allo studio della lingua albanese*, Padova: Istituto di Glottologia - Seminario di Filologia Balcanica

<sup>26</sup> PELLEGRINI, Giovan Battista (1995): *Avviamento alla linguistica albanese*, Palermo: Istituto di Albanologia - l'Università di Palermo

<sup>27</sup> PELLEGRINI, Giovan Battista (1997): *Avviamento alla linguistica albanese (Edizione rinnovata)*, Rende: Centro Editoriale e Librario - Università della Calabria [Studi e Testi di Albanistica, 7]

Por përveç prodhimitarisë shkencore duhet theksuar dhe kontributi i veçantë që PELLEGRINI dha në kuadrin e veprimtarisë didaktike në lëmin e filologjisë shqipe, si dhe në formimin e albanologëve të rinj. Nxënësja e tij, Monica GENESIN, është sot një ndër albanologet e mirëfillta më aktive dhe të pasionuara italiane, që shpie përpara traditën e shkëlqyer të Mësuesit të saj<sup>28</sup>.

Për kontributin e tij shkencor Giovan Battista PELLEGRINI meriton një vend të nderuar edhe në historinë e albanologjisë. Me ndarjen e tij nga jeta, jo vetëm kultura italiane, por dhe filologjia ballkanike humbën një personalitet të ndritur.

---

<sup>28</sup> Një tjetër nxënës i PELLEGRINIT, që fillimisht tregoi interes për albanologjinë është dhe Federico VICARIO, aktualisht i dhënë vetëm pas studimeve filologjike mbi friulanishten. Hulumtimet e tij të vetme albanologjike, në të cilat paraqit problemet e trajtuara në punën e tij të diplomës, të drejtuar prej PELLEGRINIT, janë: *L'influsso lessicale veneto in albanese*, në: *Balkan Archiv* (Neue Folge) 17/18 (1992-1993), f. 185-232, dhe *Elementi veneti in albanese*, në: CORTELAZZO, Manlio (1990) (a cura di): *Guida ai dialetti veneti*, Padova: CLEUP, f. 33-45.